



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-074

Prishtinë, më 3 shtator 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 SHTATOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Xhavit Haliti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Presidenca: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27 gusht 2012,
2. Plotësimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare më 6 shtator 2012,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 gusht 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 gusht 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Plotësimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare më 6 shtator 2012

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që rendi i ditës për mbledhjen plenare, i caktuar për më 6 shtator 2012, të plotësohet edhe me pikat e tjera, që janë përgatitur ndërkohë.

Mbledhja plenare më 6 shtator 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Projektrezolutës lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekte ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji,
17. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Mbledhja plenare, më 7 shtator 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të propozuara nga Qeveria.

Gjithashtu, Kuvendi më **10 shtator 2012** do të mbajë seancë solemne për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Në këtë seancë do të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e Grupit Ndërkombëtar Drejtues, përfaqësuesi i Zyrës Civile Ndërkombëtare, ish-presidenti Marti Ahtisari me ekipin e tij, që ka ndërmjetësuar në negociatat e Vjenës për statusin e Kosovës, përfaqësues të misioneve diplomatike të akredituara në Kosovë, si dhe të ftuar të tjerë nga jeta publike.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1 Kërkesa e deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e cekur më lart, vendosi që debati parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë të radhitet në rend dite të mbledhjes plenare në afatin kohor, sipas Rregullores së Kuvendit.

3.2 Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajorin e vitit 2012

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

3.3 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013, në bazë të qarkores së dytë të Ministrisë së Financave

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i informoi në hollësi anëtarët e Kryesisë lidhur me kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013, në bazë të qarkores së dytë të Ministrisë së Financave.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013, në bazë të qarkores së dytë të Ministrisë së Financave, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të qarkores së dytë të Ministrisë së Financave 2013/02, sipas pasqyrave të paraqitura.
2. Kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013 i dërgohen Ministrisë së Financave, që të përfshihen në projektbuxhetin për vitin 2013.

Lidhur me këtë, Kryesia gjithashtu nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bashkëpunim me dy nënkryetarët e Kuvendit, ta hartojë një projekt-analizë lidhur me investimet kapitale në Kuvendin e Kosovës, si në vijim:
 - Rirregullimi i sallës së seancave plenare,
 - Instalimi i teknologjisë informative lidhur me E-Parlamenti,
 - Objekti i Qendrës Protokollare në Gërmi,
 - Investimet e tjera për funksionalizimin e hapësirave të Kuvendit.
2. Projekt-analiza t'i paraqitet Kryesisë së Kuvendit për miratim.

3.4 Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Britani të Madhe

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Hydajet Hyseni, në Britani të Madhe, prej 5-9 nëntor 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe të ushqimit për të lartpërmendurin në paragrafin (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

4. Të ndryshme

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, i informoi të pranishmit për takimin që kishte pasur me disa deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe përfaqësues të SHBA-ve që merren me organizimin e takimit Lutjet e Mëngjesit. Ata ishin të mendimit që Kosova të jetë nikoqire e këtyre takimeve në vitin 2013. Ai propozoi që Kryesia e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare të takohen nesër për të diskutuar lidhur me këtë çështje.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi që takimi me kryetarët e grupeve parlamentare të mbahet nesër, në orën 10:00, për të diskutuar lidhur me përgatitjet për organizimin e takimit Lutjet e Mëngjesit për vitin 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale